

INSPIRED TECH SH.P.K.

Rr. Bardhyl Çausi, Ob. C15/10, Nr. 3, 10000 Prishtinë, Kosovë | NUI / Nr. fiskal: 810120882 | info@inspired-tech.info | +383 49 370 592 | www.inspired-tech.info

Për:	ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT (OSHP) Rr. "Migjeni" (ish-Banka e Ljublanës, kati V), 10000 Prishtinë
Ankues:	Inspired Tech SH.P.K., NUI 810120882, Rr. Bardhyl Çausi, Ob. C15/10, Nr. 3, Prishtinë, e përfaqësuar nga z. Fatos Halilaj, Drejtor
Autoriteti Kontraktues:	Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural (MBPZHR), Rr. Ukshin Hoti, Kompleksi "Ramiz Sadiku", 10000 Prishtinë
Nr. i Prokurimit:	203-26-5118-2-2-1
Titulli i aktivitetit:	"Shërbime konsulentë për nevoja të DAESB - MBPZHR-së (Konsulent Programer) - Ritender"
Data:	23.09.2026, Prishtinë

ANKESË

(sipas nenit 108/A dhe neneve 109-113 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjet nr. 04/L-237, 05/L-068 dhe 05/L-092 - në vijim: "LPP")

Kundër: Vendimit të Autoritetit Kontraktues mbi shqyrtimin e kërkesës për rishqyrtim, të datës 21.09.2026, dhe Njoftimit "B58 - Njoftim mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues" (rivlerësim) të datës 16.09.2026

I. PRANUESHMËRIA E ANKESËS

- Procedura paraprake e zgjidhjes së mosmarrëveshjes është shterur: ankuesi parashtroi me kohë Kërkesën për Rishqyrtim më 18.09.2026, të cilën Autoriteti Kontraktues (në vijim: "AK") e refuzoi si të pabazuar me Vendimin e datës 21.09.2026, duke e lënë në fuqi Njoftimin B58 të datës 16.09.2026.
- Ankesa parashtrohet brenda afatit prej dhjetë (10) ditësh nga vendimi i AK-së në procedurën paraprake (neni 108/A i LPP-së; këshilla juridike në vetë Vendimin e AK-së; FDT, neni 31.4).
- Tarifa e ankesës në shumën prej 210.00 € (një përqind e vlerës së parashikuar të kontratës prej 21,000.00 €) është paguar dhe dëshmia e pagesës i bashkëngjitet ankesës.
- Ankuesi ka interes juridik të drejtpërdrejtë: është ofertues pjesëmarrës me tender të përgjegjshëm të dorëzuar me kohë dhe me çmimin më të ulët ndër ofertat e pranura (19,305.00 €), i eliminuar me vendimin e kundërshtuar.
- Me dorëzimin e kësaj ankese, zbatimi i aktivitetit të prokurimit pezullohet sipas nenit 112, paragrafi 1, i LPP-së.

II. RRJEDHA E PROCEDURËS DHE GJENDJA FAKTIKE

- AK publikoi njoftimin e kontratës dhe Dosjen e Tenderit (25.06.2026) për kontratë publike kornizë 36-mujore për shërbime, me vlerë të parashikuar 21,000.00 € (FDT 2.6), procedurë të hapur dhe kriter dhënieje "tenderi ekonomiksht më i favorshëm" (teknik 80% / financiar 20%, nota minimale teknike 50 pikë; FDT 28.1, 29.3, 30.1). Faqja e ballinës së dosjes mban shënimin "Shërbime të veçanta"; megjithatë, asnjë dispozitë e dosjes nuk përmban ndonjë kufizim të pjesëmarrjes në persona fizikë, ndonjë referencë në nenin 57 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (në vijim: "Rregullorja"), e as ndonjë kërkesë për regjistrim si "OE - Person fizik".
- Më 29.06.2026, ankuesi dorëzoi tenderin (B66, kodi IT-DAESB) me çmim 19,305.00 € (270 ditë × 71.50 € bruto), duke propozuar si konsulent programer z. Fatos Halilaj, me të gjitha dëshmitë e kërkuara me dosjen: Deklaratën nën betim (Aneksi 2), letërnjoftimin (FDT 7.1), diplomat universitare, CV-në, certifikatën e gjuhës angleze dhe Metodologjinë e Planin e Punës të nënshkruar e të vulosur (FDT 9.1).

3. Në procedurë morën pjesë tre ofertues: Përparim Zejnullahu (19,760.40 €), Inspired Tech SH.P.K. (19,305.00 €) dhe Arbnor Halili B.I. (54,000.00 €).

4. Me Njoftimin B58 të datës 16.09.2026, pas rivlerësimit, kontrata iu dha ofertuesit Përparim Zejnullahu (19,760.40 €), ndërsa ankuesi u eliminua (Letra B42) me arsyetimin e vetëm se oferta u paraqit nga person juridik, ndërsa aktiviteti qenka prokurim për shërbim kontraktor individual sipas pikës 57.5 të Rregullores.

5. Kërkesa për rishqyrtim e ankuesit, e datës 18.09.2026, u refuzua me Vendimin e AK-së të datës 21.09.2026, në të cilin AK, ndër tjera: (i) pranon shprehimisht se personat juridikë mund të jenë operatorë ekonomikë dhe të marrin pjesë në procedura të prokurimit publik; (ii) nuk e konteston se dokumentacioni i dosjes ishte i përgjithshëm për operatorë ekonomikë; (iii) nuk e konteston se konsulenti i propozuar i plotëson kualifikimet dhe përvojën e kërkuar; dhe (iv) e mbështet eliminimin ekskluzivisht në zbatimin ex lege të pikës 57.5 të Rregullores dhe në shënimin "Shërbime të veçanta" të faqes së ballinës së dosjes.

III. PRETENDIMET ANKIMORE

Pretendimi 1: Eliminimi mbi një kërkesë të pashpallur qartazi shkel nenin 59 të LPP-së dhe parimin e transparencës (neni 1 i LPP-së). Sipas nenit 59 të LPP-së dhe vetë dosjes (FDT 27.1, 27.2 dhe 29.2; njësoj neni 41 i Rregullores/RRUOPP-së), tenderët ekzaminohen dhe vlerësohen vetëm sipas kërkesave të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Kërkesat kualifikuese dhe shkaqet e përjashtimit duhet të formulohen në mënyrë të qartë, precize dhe të padyshimtë, në mënyrë që çdo ofertues normalisht i informuar dhe i kujdesshëm t'i kuptojë njësoj; një operator ekonomik nuk mund të përjashtohet për mospërmbushjen e një detyrimi që nuk del shprehimisht nga dokumentet e tenderit, por vetëm nga një interpretim i mëvonshëm i autoritetit. Në rastin konkret, i vetmi element mbi të cilin mbështetet AK është një shënim i faqes së ballinës ("Shërbime të veçanta") - një etiketë tipografike që nuk përmban asnjë normë, nuk përcakton asnjë kusht pjesëmarrjeje dhe nuk shoqërohet me asnjë dispozitë operative kudo në dosje: askund nuk thuhet se mund të ofertojnë vetëm personat fizikë, askund nuk citohet neni 57 i Rregullores dhe askund nuk kërkohet regjistrimi si "OE - Person fizik" - edhe pse pikërisht ky do të ishte informacioni i vetëm thelbësor për rrethin e ofertuesve të lejuar. Paqartësia dhe mangësia e dosjes i ngarkohen hartuesit të saj (Rregullorja/RRUOPP 18.4 dhe 18.7), jo ofertuesit që ka vepruar në mirëbesim sipas saj. Vetë AK në Vendimin e datës 21.09.2026 e pranon se dokumentacioni ishte i përgjithshëm për operatorë ekonomikë - pra pranon se përjashtimi ynë nuk buron nga teksti i dosjes, por nga interpretimi i saj i bërë pas hapjes së ofertave.

Pretendimi 2: Dosja e tenderit, e lexuar në tërësinë e saj, e legjitimon pjesëmarrjen e personit juridik që propozon konsulentin - andaj është së paku thellësisht kontradiktore, dhe kontradikta interpretohet në favor të ofertuesit. Përveç mungesës së çdo kufizimi, përmbajtja operative e dosjes pozitivisht e parashihet pjesëmarrjen e subjekteve juridike:

a) FDT 1.6(d): ofertuesit referohen si "operator ekonomik" apo "tenderues", pa kufizim të formës juridike;

b) neni 6 i dosjes (pranueshmëria sipas nenit 65 të LPP-së) përmban rrethana që vlejnë vetëm për subjekte afariste: falimentimi, likuidimi, marrëveshjet me kreditorë, vonesat në pagimin e pagave të punonjësve;

c) FDT 6.4 i kërkon Vërtetimin e ATK-së dhe Vërtetimin e Gjykatës "për të propozuarin për kontratë" - formulim që bën dallim të qartë ndërmjet tenderuesit dhe personit fizik të propozuar për kryerjen e shërbimit, dhe që ka kuptim vetëm nëse tenderuesi mund të jetë subjekt që propozon një individ;

d) lejohen shprehimisht grupi i operatorëve ekonomikë (neni 11) dhe nënkontraktimi (neni 12);

e) dispozita "Personat ligjor duhet të tregojnë emrat e kualifikimeve profesionale të personelit përgjegjës për ekzekutimin e shërbimeve" - të cilën ankuesi e ka zbatuar pikërisht ashtu, duke e emëruar konsulentin përgjegjës;

f) formularët e vetë AK-së: Aneksi 1 kërkon "Emri i kompanisë"; Aneksi 2 përmban tabelën "Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)" me fushat "I përfaqësuar nga", "Pozita" dhe "Vula"; Metodologjia kërkohet "e nënshkruar dhe e vulosur" (FDT 9.1, 19.1(h));

g) siguria e ekzekutimit prej 10% të vlerës së kontratës (FDT 14.2), kontrata kornizë 36-mujore dhe kriteri MEAT me nënkritere e pesha - elemente të kontratës klasike të shërbimeve me operator ekonomik;

h) vetë numri i prokurimit 203-26-5118-2-2-1 e klasifikon aktivitetin me kodin e llojit "2 - Shërbim" (Rregullorja/RRUOPP 15.5 dhe 16.2), e jo si shërbim konsulence apo shërbim i veçantë.

Përgjigjja e AK-së se këto qenkan "elemente standarde" që nuk krijojnë të drejta, e përmbys barrën në mënyrë të palejueshme: dosja e tenderit është materiali themelor mbi bazën e të cilit operatorët ekonomikë i përgatisin tenderët e tyre (Rregullorja/RRUOPP 18.4) dhe pikërisht AK-ja ka pasur për detyrë ta përgatisë atë pa kontradikta. Një ofertues nuk mund të detyrohet të hamendësojë se një etiketë e ballinës i shfuqizon në heshtje dhjetëra dispozita operative të po asaj dosjeje. Kontradikta e brendshme e dokumentit i ngarkohet hartuesit dhe interpretohet në favor të ofertuesit.

Pretendimi 3: Edhe sipas qëndrimit të vetë AK-së - nëse aktiviteti i nënshtrohet regjimit të nenit 57 të Rregullores - procedura është zhvilluar në kundërshtim rrënjësor me atë regjim, andaj vendimi i kundërshtuar është i paligjshëm dhe aktiviteti duhet të anulohet, e jo të përfundojë me dhënie kontrate nën një dosje të paligjshme. Regjimi i shërbimeve të veçanta zbatohet, sipas pikës 57.2 të Rregullores, vetëm për shërbime që nuk mund të sigurohen përmes procedurave të rekrutimit sipas Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrat Publike - parakusht ky që AK nuk e ka konstatuar e as arsyetuar askund në njoftim apo dosje. Po ashtu, ai regjim ka rregullat dhe dokumentacionin e vet standard të miratuar nga KRPP-ja; AK nuk i ka zbatuar ato, por ka përdorur dosjen standarde të kontratës publike kornizë për shërbime, me siguri ekzekutimi, kriter MEAT, kohëzgjatje 36-mujore dhe klasifikim "2 - Shërbim". Rrjedhoja juridike është e pashmangshme: nëse regjimi i nenit 57 vlen, atëherë i tërë aktiviteti - përfshirë dhënien e kontratës ofertuesit Përparim Zejnullahu - është zhvilluar mbi bazë dokumentare e procedurale të kundërligjshme dhe duhet të anulohet sipas nenit 62 të LPP-së, me urdhër për rishpallje me dosje të përgatitur sipas regjimit përkatës dhe me kushte të qarta pjesëmarrjeje. E paligjshme është pikërisht zgjidhja hibride e AK-së: ta trajtojë dosjen si të pavlefshme vetëm ndaj njërit ofertues (duke e eliminuar), por si plotësisht të vlefshme për dhënien e kontratës një ofertuesi tjetër.

Pretendimi 4: Shkelje e parimit të trajtimit të barabartë (neni 7 i LPP-së) me dëm të drejtpërdrejtë për fondet publike (nenet 1 dhe 6 të LPP-së). I njëjti dokument tenderi zbatohet me dy standarde: ndaj ankuesit si burim përjashtimi, ndaj fituesit si bazë e vlefshme kontraktimi. Pasoja financiare e këtij trajtimi të pabarabartë është dhënia e kontratës me çmim 455.40 € më të lartë (19,760.40 € kundrejt 19,305.00 €). Përgjigjja e AK-së se çmimi merret parasysh vetëm mes ofertave të pranueshme qëndron vetëm nëse eliminimi është i ligjshëm - gjë që, për arsyet e parashtruara në Pretendimet 1-3, nuk është.

IV. PROPOZIMI I PROVAVE

Përveç shkresave të bashkëngjitura, i propozojmë Panelit Shqyrtues që nga sistemi i prokurimit elektronik të administrohen si prova: (a) Njoftimi për Kontratë (B05) i këtij aktiviteti, për t'u konstatuar se as ai nuk përmban kufizim të pjesëmarrjes në persona fizikë e as referencë në regjimin e nenit 57 të Rregullores; (b) Dosja e Tenderit ashtu siç është publikuar në platformë; (c) raporti i vlerësimit dhe i rivlerësimit të tenderëve, si dhe ankesa e operatorit ekonomik që i parapriu rivlerësimit; dhe (d) sipas nevojës, ekspertizë e ekspertit shqyrtues lidhur me përputhshmërinë e dosjes me regjimin e pretenduar të shërbimeve të veçanta.

V. KËRKESA (PETITUMI)

I kërkojmë Organit Shqyrtues të Prokurimit që:

1. Ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar;


2. Ta anulohet Vendimin e AK-së të datës 21.09.2026 mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, si dhe Njoftimin B58 mbi vendimin e AK-së (rivlerësim) të datës 16.09.2026 për dhënien e kontratës;
3. Ta urdhërohet AK-në që ofertën e ankuesit ta kthejë në rivlerësim dhe ta vlerësojë e pikëzojë sipas kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit (FDT 28.1 dhe 30.1);
4. Alternativisht - nëse Paneli Shqyrtues konstaton se aktiviteti i nënshtrohet regjimit të nenit 57 të Rregullores nr. 001/2022 - ta anulohet aktivitetin e prokurimit në tërësi sipas nenit 62 të LPP-së dhe ta urdhërohet AK-në që ta rishpallë atë me dosje të përgatitur sipas atij regjimi dhe me kushte të qarta e të padyshimta pjesëmarrje;
5. Ta konstatojë pezullimin e zbatimit të aktivitetit të prokurimit sipas nenit 112, paragrafi 1, i LPP-së, deri në vendosjen përfundimtare;
6. Ta urdhërohet kthimin e tarifës së ankesës në shumën prej 210.00 €.

VI. SHTOJCAT

6. Dëshmia e pagesës së tarifës së ankesës (210.00 €).

Me respekt,

Për ankuesin **INSPIRED TECH SH.P.K.**


Fatos Hamaj, Drejtor
(nënshkrimi dhe vula)

